



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI**

Nr. 499/9 Prot.

Tiranë, më 22 . 07 . 2026

**V E N D I M**

**Nr. 204 , Datë 22 . 07 . 2026**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 66 Regj., datë 04.03.2026, paraqitur nga shtetasi D. C, kundër Bashkisë Berat, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” dhe “*gjendjes ekonomike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës nga subjekti ankues, shtetasi D. C, parashtrohet si më poshtë vijon:

D. C është person me statusin e të verbërit, grupi I-rë. Edhe bashkëshortja e tij, gjithashtu është person me aftësi të kufizuara dhe trajtohet me pagesë paaftësie. Të ardhurat familjare përbëhen vetëm nga pagesat e përfituara nga pagesat e paaftësisë.

Ankuesi shprehet se aktualisht jetojnë në një hapësirë banimi prej vetëm 16 m<sup>2</sup>, e papërshtatshme për standardet minimale të jetesës, për shkak të kushteve shëndetësore dhe sociale në të cilat ndodhen. Për këtë arsye ka marrë me qira një banesë për të cilin kanë lidhur një kontratë qiraje dhe paguajnë 13.000 lekë qira mujore.

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Më datë 12.12.2025, ka aplikuar pranë Bashkisë Berat për përfitimin e bonusit të qirasë, duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, përfshirë edhe kontratën e qirasë, të noterizuar.

Më datë 31.01.2026, është vënë në dijeni se familja tij nuk është shpallur përfituese e këtij programi, por shprehet se nuk ka marrë asnjë njoftim zyrtar me shkrim mbi arsyet e skualifikimit.

Subjekti ankues pretendon se, duke qenë se ai dhe bashkëshortja e tij i përkasin një kategorie të mbrojtur, (persona me aftësi të kufizuara) si dhe ndodhur në kushte të vështira shëndetësore dhe social-ekonomike, konsideron se mosvlerësimi i situatës së tyre dhe përjashtimi nga përfitimi, pa arsyetim të qartë dhe pa transparencë, përbën trajtim të pabarabartë dhe potencialisht diskriminues në bazë të *aftësisë së kufizuar* dhe *gjendjes ekonomike*.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të *“aftësisë së kufizuar”* dhe *“gjendjes ekonomike”*, nga ana e Bashkisë Berat, si dhe marrjen e masave për ndreqjen e pasojave, lidhur me përfitimin e bonusit të qirasë.

## **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>2</sup>, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 499/1 prot., datë 09.03.2026, ka kërkuar nga Bashkia Berat, informacion dhe dokumentacion provues.

---

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

2. Nëpërmjet shkresës me nr. 1579/1 prot., datë 13.03.2026, Bashkia Berat, ka dërguar pranë KMD-së, parashtime duke cituar se:

Komisioni i Strehimit i Bashkisë Berat, në mbledhjen e datës 22.01.2026, ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga 67 familje, të cilat kishin aplikuar për bonus qiraje.

Pas shqyrtimit, Komisioni i Strehimit arriti në konkluzionin se nga 67 kërkesa, kualifikohen 63 familje, ndërsa 4 kërkesa u skualifikuan për mungesë dokumentacioni ose që nuk plotësonin kushtet ligjore për t'u trajtuar me bonus qiraje.

Lidhur me rastin e subjektit ankues, Bashkia sqaron se, D. C me përbërje familjare prej dy personash, ka në pronësi një banesë të ish-Kursi i Partisë, të privatizuar me Kontratën e Shitjes nr. 785 rep., nr. 88/2 kol., datë 17.03.2014, me palë shitëse, Bashkinë Berat dhe blerës, D. C dhe B. C, me vlerë 95.369 lekë.

D dhe B. C kanë në pronësi një banesë me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup> dhe posedojnë një pjesë të korridorit/ambientit të përbashkët, me sipërfaqe 5 m<sup>2</sup>, ku ka ndërtuar një tualet pa leje. Aktualisht kjo familje jeton në një banesë me sipërfaqe 21 m<sup>2</sup>.

Bazuar në VKM nr. 814, datë 03.12.2004 "Normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit", sipërfaqja për një familje prej dy personash duhet të jetë 20-21 m<sup>2</sup>. D. C ka depozituar kontratën e qirasë me vlerë 13.000 lekë në muaj.

Bashkia shprehet se ky fakt nuk u mor në konsideratë nga ana e Komisionit, pasi në Bashkinë Berat ka një numër të konsiderueshëm familjesh të pastreha që nuk kanë përfituar asnjë m<sup>2</sup> nga shteti, dhe po kështu ka një numër të konsiderueshëm familjesh që jetojnë nën normat e strehimit, ndërsa për rastin e z. C shprehet se konsideron kjo familje banesën aktuale e ka marrë nga Bashkia, pra është trajtuar një herë nga ky institucion.

Bashkia parashtroi se, nga ana financiare e ka të pamundur të përballojë një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të pastrehë dhe të atyre që janë nën normat e strehimit.

Lidhur me rastin e z. C, Bashkia shprehet se ajo merr përsipër trajtimin me bonus qiraje në një banesë të përshtatshme për kushtet sociale të familjes së z. C për një periudhë pa afat, me kushtin që ai të dorëzojë ambientin e dhënë nga Bashkia si të papërshtatshëm për banesë për këtë familje, dhe pse privatizimi është bërë me kërkesën e tij, ose trajtimin me banesë sociale nga fondi i banesave që vetë Bashkia ka krijuar nga kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik.

Bashkia informon se, objekti ish-Kursi i Partisë, mbas viteve 1990 është zënë nga qytetarët e pastrehë si ambient banimi. Me vendim të Këshillit Bashkiak Berat nr. 57, datë 13.10.1995, është miratuar pajisja me vendime provizore për 24 familjet që ishin strehuar në këtë objekt. Familja e z. C nuk është pjesë e kësaj liste, pasi pjesë e saj ka qenë familja e z. A. B.

Në zbatim të Urdhrit nr. 240, datë 15.09.2011, të Kryetarit të Bashkisë “Për verifikimin e dokumentacionit që banorët e kësaj godine dispononin”, rezultoi se në ambientet e katit të dytë me nr. 16, në të cilin me vendim provizor të Këshillit Bashkiak ishte strehuar qytetari A. B, aktualisht ishte strehuar familja e D. C, pa asnjë dokument ligjor, pra ishte zaptuar jo vetëm ambienti i A. B por edhe ambienti përballë, i cili me vendimin provizor të Këshillit Bashkiak ishte miratur për strehim për familjen Dh. B.

Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 11, datë 11.03.2013, ka miratur “Kalimin në fond banese të objektit ish-Kursi i Partisë”, ku D. C i është miratur strehimi në banesën me nr. 16, kati i dytë, vendim ky që i hapi rrugë privatizimit të tyre duke plotësuar një kërkesë të vazhdueshme prej 18 vitesh, të banorëve.

3. Në vijim të përgjigjes së dërguar nga Bashkia Berat, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 499/3 prot., datë 27.03.2026, ka kërkuar sërish informacion dhe dokumentacion shtesë.
4. Me shkresën me nr. 1579/3 prot., datë 14.04.2026, Bashkia ka dërguar pranë KMD-së, kopje të dokumentacionit poshtë cituar:
  - Certifikatë pronësie të banesës së z. D. C, ku shprehet sipërfaqja e saj;
  - Aktit provues që z. D. C dhe B. C kanë përfituar tokë në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, dhe se kjo familje është bërë pjesë e Bashkisë Berat në muajin shkurt të vitit 2004, ardhur nga fshati Lapardhja, Njësia Administrative Otlak;
  - Sipërfaqes “de facto” të banesës, provuar me fotot bashkëlidhur dhe planimetrinë e ambientit;

Nga ana e Bashkisë citohet se ankuesit i është propozuar strehimi në një apartament të banesave sociale, propozim që është refuzuar nga ana e ankuesit.

5. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa më të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 499/6 prot., datë 15.05.2026, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore
6. Seanca u zhvillua në datën 04.06.2026, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e subjektit ankues dhe bashkëshortes së tij, znj. B. C<sup>3</sup>, si dhe përfaqësuesve me Autorizim të Bashkisë Berat<sup>4</sup>: znj. Z. L, me detyrë Juriste dhe znj. M. K, me detyrë Specialiste e Pronave dhe Strehimit, pranë kësaj Bashkie.

Të dyja palët në këtë proces administrativ u qëndruan të njëjtave parashtrime e argumenta që kishin dërguar paraprakisht pranë KMD-së në mënyrë shkresore. Përfaqësueset e Bashkisë depozituan

---

<sup>3</sup> Sipas deklarimit verbal të ankuesit, z. D. C, gjatë seancës dëgjimore.

<sup>4</sup> Autorizim përfaqësimi pranë KMD-së, datë 01.06.2026.

gjatë seancës shkresën nr. 3082/1 prot., datë 03.06.2026 dhe dokumentacion shtesë, i cili është administruar në cilësi prove nga KMD dhe është analizuar gjatë arsyetimit të këtij Vendimi.

7. Me shkresën nr. 3782 prot., datë 19.06.2026, Bashkia Berat, ka dërguar pranë KMD-së sqarime të tjera (bashkëlidhur dokumentacionin respektiv), duke evidentuar ndër të tjera, se:

Me Urdhrin nr. 460, datë 05.06.2026, Kryetari i Bashkisë Berat ngriti grupin e punës “Për verifikimin e gjendjes faktike të hapësirës së poseduar nga D. C, të korridorit të përbashkët te objekti ish-Kursi i Partisë, me adresë në lagjen “30 Vjetori”, Shkalla1, kati II”.

Referuar Procesverbalit me nr. 3448/1 prot., datë 16.06.2026, si dhe Planimetrisë së Objektit (bashkëlidhur këtij Procesverbali), rezulton se: grupi i punës, pasi bëri verifikimin dhe matjen në vend nga specialisti topograf, në prani të familjes C, të hapësirës së korridorit të përbashkët të poseduar nga ana e z. C, konstatoi se, hapësira e poseduar është një sipërfaqe prej 5 m<sup>2</sup> dhe është kthyer në tualet.

Në shkresë citohet se, Bashkia Berat i ka propozuar dhe vazhdon t’i propozojë familjes C strehimin në një apartament të banesave sociale, prona të Bashkisë me qira mujore 0 (zero) lekë në muaj me kontratë qiraje vjetore me të drejtë rinovimi çdo vit, si familje e përbërë nga persona me aftësi të kufizuara, bazuar në legjislacionin për strehimin social.

8. Njëzet e-mailit datë 08.07.2026, subjekti ankues konfirmon faktin e ofrimit nga ana e Bashkisë të banesës sociale, dhe shpjegon se e kanë refuzuar pasi ndodhet shumë larg rrugës kryesore, stacionit të autobusëve dhe spitalit. Subjekti ankues thekson faktin se ka kërkuar bonus qiraje nga ana e Bashkisë dhe jo banesë sociale.

## **II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë**

*Nga shqyrtimi i rrethanave dhe dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, evidentohet se:*

Z. D. C ka në pronësi një banesë të llojit Apartament me numër pasurie 15/269+1-16, ZK 8502, Vol. 23, fq 130. Ky apartament ka një sipërfaqe prej 16 m<sup>2</sup> dhe është përfituar përmes një kontrate shitjeje për privatizim më datë 17.03.2014, ku shitës ka qenë Bashkia Berat dhe blerës Z. C, për vlerën 95,369 lekë. Përveç kësaj, ai posedon që prej këtij viti (me dakordësinë e Bashkisë Berat<sup>5</sup>) edhe 5 m<sup>2</sup> korridor nga ambienti i përbashkët, duke e çuar hapësirën faktike të banimit në 21 m<sup>2</sup>.

Me datë 12.12.2025, ankuesi ka aplikuar pranë Bashkisë Berat për përfitimin e bonusit të qirasë.

---

<sup>5</sup> Referuar shkresës me nr. 410 regj., datë 23.07.2014, të Bashkisë Berat.

Komisioni i Strehimit i Bashkisë Berat, në mbledhjen e datës 22.01.2026, ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga 67 familje, të cilat kishin aplikuar për bonus qiraje.

Lidhur me rastin e subjektit ankues, pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni i Strehimit, pranë Bashkisë Berat nuk e kualifikoi z. C në listën e përfituesve, me arsyetimin se aktualisht kjo familje jeton në një banesë me sipërfaqe 21 m<sup>2</sup>.

Pretendimi i ankuesit kundrejt Bashkisë lidhet me faktin se ai ka në pronësi një banesë prej 16 m<sup>2</sup>, që është nën normat e strehimit të lejueshme për një familje të përbërë prej 2 personash, si dhe për faktin se si person me aftësi të kufizuar duhet trajtuar me përparësi në dhënien e bonusit të qirasë, për të mundësuar banimin në një ambient me sipërfaqe të përshtatshme banimi.

Nga shpjegimet dhe dokumentacioni i depozituar nga Bashkia rezulton se mosmiratimi i kërkesës nuk është mbështetur në aftësinë e kufizuar apo gjendjen ekonomike të ankuesit, por në vlerësimin administrativ të situatës së strehimit të familjes, konkretisht faktin se familja disponon një banesë në pronësi, e përfituar dhe privatizuar sipas procedurave ligjore, si dhe në nevojën për të prioritetizuar familjet që nuk disponojnë asnjë banesë. Bashkia ka argumentuar gjithashtu kufizimet e fondit financiar të programit të bonusit të qirasë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës rezulton se Bashkia Berat ka argumentuar dhe provuar se vendimmarrja është mbështetur në kriteret objektive dhe të përgjithshme të programit të strehimit social, të zbatueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë aplikantët.

Komisioneri vlerëson se Bashkia Berat ka vepruar në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, të ndryshuar, i cili parashikon se përzgjedhja e përfituesve të programeve sociale të strehimit kryhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, të miratuar dhe të publikuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore, si dhe në varësi të fondeve të disponueshme. Për rrjedhojë, fakti që ankuesi nuk është shpallur përfitues i bonusit të qirasë nuk përbën, në vetvete, trajtim të pafavorshëm apo diskriminues, për sa kohë Bashkia ka bazuar vendimmarrjen në kriteret e programit dhe ka ofruar një alternativë tjetër strehimi social, konkretisht sistemimin në një banesë sociale me qira zero lekë.

Sipas nenit 16, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, kriteri i parë për të përfituar nga programet sociale është që individit ose familja të mos disponojë banesë në pronësi. Z. C ka një certifikatë pronësie për një apartament (pasuria nr. 15/269+1-16). Ligji nuk i jep diskrecion Bashkisë që të injorojë apo moskonsiderojë ekzistencën e një prone.

Skualifikimi i aplikantit ka ndodhur për shkak të një kriteri plotësisht objektiv (pronësia).

Komisioni i Strehimit i Bashkisë Berat arriti në konkluzionin se nga 67 kërkesa, kualifikohen 63 familje, ndërsa 4 kërkesa u skualifikuan për mungesë dokumentacioni ose që nuk plotësonin kushtet, kriteret ligjore për t’u trajtuar me bonus qiraje.

Nga të dhënat e “Listës së përfituesve të subvencionimit të qirasë për Bashkinë Berat për vitin 2026”, rezulton se, kategoritë përfituese të bonusit të qirasë janë: personat me AK (14 raste), gra të

divorcuara, kryefamiljare, gra të veja, pakica egjiptane/rome, pensionistë dhe me ndihmë ekonomike, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, etj.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerësoi nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se aplikantë të tjerë që ndodheshin në një situatë faktike dhe juridike të krahasueshme. Nga provat e administruara nuk rezulton se persona të tjerë, të cilët dispononin banesë në pronësi dhe ndodheshin në të njëjtat kushte të programit të bonusit të qirasë, janë trajtuar më në mënyrë më të favorshme vetëm për shkak se nuk i përkisnin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara ose kishin një gjendje ekonomike të ndryshme. Përkundrazi, rezulton se kriteret e përzgjedhjes janë zbatuar mbi bazën e elementëve objektivë të parashikuar nga legjislacioni për strehimin social.

Sipas VKM nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, norma e strehimit për një familje me 2 persona është 20–21 m<sup>2</sup>.

Certifikata familjare e z. C vërteton se familja përbëhet nga 2 persona.

*Hapësira faktike* e shtëpisë së aplikantit është *ekzaktesisht 21 m<sup>2</sup>*, ndaj ai nuk konsiderohet i pastrehë. Rrjedhimisht, nga pikëpamja e përcaktimeve të mësipërme, ankuesi nuk mund të klasifikohet si “i pastrehë” apo “nën normë” për t’u klasifikuar përpara kategorive të tjera të aplikantëve.

Nga 67 aplikime që mori në shqyrtim Komisioni i Strehimit, 63 familje u shpallën fituese të bonusit të qirasë. Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak (VKB Nr. 5, datë 30.01.2026), në listën e fituesve u përfshinë familje që i përkisnin këtyre kategorive:

- Persona me aftësi të kufizuara dhe invalidë.
- Familje në vështirësi të rënda ekonomike që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Kryefamiljarë pensionistë.
- Gra të divorcuara që rrisin fëmijë të vegjël.
- Familje nga komuniteti egjiptian.

Vendimi i Bashkisë nuk lidhet me “*aftësinë e kufizuar*” apo “*gjendjen ekonomike*” të ankuesit pasi në listën e fituesve (VKB Nr. 5, datë 30.01.2026) ka shumë familje me të njëjtin status (invalidë, me ndihmë ekonomike, etj.) që kanë përfituar sepse plotësonin kriterin e pronësisë.

Sipas nenit 11, pika 2, e ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të mundësojë kalimin e familjeve që nuk kualifikohen në një program strehimi në një program tjetër, kur plotësojnë kushtet ligjore.

Nga dokumentacioni rezulton se Bashkia ka marrë në konsideratë rrethanat sociale dhe shëndetësore të familjes C. Statusi i tyre si persona me aftësi të kufizuara është konsideruar si një element që justifikon trajtim prioritar nëpërmjet një programi tjetër të strehimit social. Në këtë kuadër, Bashkia i ka propozuar familjes strehimin në një apartament të fondit të banesave sociale,

pronë e Bashkisë, me qira zero lekë në muaj, me kontratë qiraje të rinovueshme, duke garantuar një zgjidhje afatgjatë dhe më të favorshme ekonomikisht sesa përfitimi i bonusit të qirasë.

Komisioneri vëren se ky propozim nuk ka qenë hipotetik apo deklarativ, por konkret dhe i realizueshëm, pasi Bashkia ka identifikuar banesën sociale dhe ka shprehur gatishmërinë për ta vendosur atë në dispozicion të familjes C sipas legjislacionit për strehimin social. Ankuesi ka konfirmuar gjatë procedurës administrative se kjo ofertë është bërë, por është refuzuar prej tij për shkak të vendndodhjes së banesës dhe jo për shkak të mungesës së saj apo të kushteve ekonomike të ofrimit.

Komisioneri çmon se e drejta për të zgjedhur ndërmjet formave të ndryshme të mbështetjes sociale nuk nënkupton detyrimin e autoritetit publik për të akorduar domosdoshmërisht përfitimin specifik të kërkuar nga aplikanti, nëse autoriteti ofron një alternativë tjetër të ligjshme, konkrete dhe të përshtatshme për përmbushjen e të njëjtit qëllim, atë të sigurimit të strehimit.

Në vlerësimin e proporcionalitetit të veprimeve të Bashkisë, Komisioneri çmon se autoriteti publik jo vetëm ka shqyrtuar kërkesën për bonus qiraje sipas kritereve të programit, por ka identifikuar dhe ofruar një masë alternative konkrete për garantimin e strehimit të familjes C. Kjo alternativë synon të realizojë të njëjtin qëllim publik, sigurimin e strehimit të përshtatshëm për familjet në nevojë, duke mbajtur parasysh fondet e kufizuara të programit të bonusit të qirasë dhe detyrimin për trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve. Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se veprimet e Bashkisë nuk rezultojnë joproporcionale në raport me qëllimin e ndjekur.

Po kështu, nuk rezulton që Bashkia t'i ketë mohuar familjes C aksesin në programet sociale të strehimit. Përkundrazi, nga provat rezulton se institucioni ka ndërmarrë hapa aktivë për të identifikuar një zgjidhje konkrete, duke propozuar një banesë sociale pa pagesë qiraje, çka demonstroi se familja nuk është përjashtuar nga mbështetja sociale për shkak të aftësisë së kufizuar apo gjendjes ekonomike.

Fakti që ankuesi e ka konsideruar vendndodhjen e banesës së ofruar si të papërshtatshme për nevojat e tij personale nuk e bën, në vetvete, ofertën e Bashkisë të paarsyeshme apo diskriminuese. Vlerësimi subjektiv i ankuesit mbi përshtatshmërinë e një zgjidhjeje të ofruar nuk mjafton për të provuar se autoriteti publik ka ushtruar trajtim të pafavorshëm në kuptim të ligjit nr. 10221/2010.

Komisioneri çmon se e drejta e aplikantit për të kërkuar përfitimin nga një program i caktuar strehimi nuk krijon detyrimin për autoritetin publik që të akordojë domosdoshmërisht atë program, kur, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ekziston një formë tjetër mbështetjeje që realizon të njëjtin qëllim publik, sigurimin e strehimit për familjen në nevojë.

Vendimmarrja e Bashkisë Berat rezulton të jetë mbështetur në kritere objektive të programit të strehimit social dhe jo në një prej shkaqeve të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010. Për rrjedhojë, nuk konstatohet diskriminim ndaj shtetasit D. C në kuptim të këtij ligji.

Në mungesë të trajtimit të pafavorshëm e të padrejtë të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pafavorshëm e të padrejtë të tij, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun/shkaqet” e pretenduar.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Berat, lidhur me trajtimin e kërkesës së z. D. C për bonus qiraje.

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk është njoftuar me shkrim për arsyet e moskualifikimit,*

Subjekti ankues ka pretenduar gjithashtu, se nga ana e Bashkisë Berat, nuk është njoftuar lidhur me arsyet e moskualifikimit si përfitues i bonusit të qirasë.

Komisioneri vlerëson se, edhe nëse ky pretendim do të lidhej me mënyrën e administrimit të procedurës nga ana e Bashkisë, ai, në vetvete, nuk mjafton për të provuar ekzistencën e diskriminimit në kuptim të ligjit nr. 10221/2010. Objekti i shqyrtimit në këtë procedurë është të verifikohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një prej shkaqeve të mbrojtura nga ligji, çka nuk rezulton të provohet nga faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit D. C, nga ana e Bashkisë Berat, lidhur me moskualifikimin e tij për përfitimin e bonusit të qirasë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**